

V E N D I M
Nr. 208, datë 24.12.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “““
Gjergj Sauli	Anëtar i “““
Alfred Karamuço	Anëtar i “““
Kujtim Puto	Anëtar i “““
Sokol Sadushi	Anëtar i “““
Petrit Plloçi	Anëtar i “““
Kristofer Peçi	Anëtar i “““

me sekretarët Noela Ruço e Arbenka Lalica, në datat 9.5.2001 dhe 21.11.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 34 Akti që i përket:

KËRKUES: SHOQATA KOMBËTARE E RADIOTELEVIZIONEVE, përfaqësuar nga avokat Ilir Panda, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KUVENDI I SHQIPËRISË, në mungesë.
2. KËSHILLI I MINISTRAVE, në mungesë.

OBJEKTI: Papajtueshmëria me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare e paragrafit të dytë dhe të tretë të nenit 4 të ligjit nr.8655, datë 31.7.2000 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, 22, 131/a dhe 134/f të Kushtetutës dhe 27-31 e 49-51 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Për shfuqizimin e këtyre paragrafëve të nenit 4 të ligjit kërkesi parashtron këto shkaqe:

1. Kufizimi në dhënien e licencave për radion e televizionin vjen në kundërshtim me nenin 22 të Kushtetutës që përcakton se “Liria e shtypit, e radios dhe e televizionit është e garantuar”.
2. Këto kufizime prekin lirinë dhe veprimtarinë ekonomike që parashikon neni 11 i Kushtetutës.
3. Duke parashikuar që të jepen vetëm 2 licenca për transmetim televiziv kombëtar dhe 4 për radio, këto paragrafë vijnë ndesh me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, që garanton lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kristofor Peçi, përfaqësuesin e kërkesit, si dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, në datën 9.5.2001, përfaqësuesi i subjektit të interesuar të Kuvendit të Shqipërisë, kërkoi shtyrjen e gjykimit, sepse për ligjin në fjalë ishin propozuar disa ndryshime, ndër të cilat edhe ato lidhur me numrin e kufizuar të licencave për televizione dhe radio kombëtare.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr.8794, datë 10.5.2001 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë””. Sipas ndryshimeve që u bënë, në nenin 4 të ligjit objekt kërkesë nuk pasqyrohen më kufizime për licenca për radiot dhe televizionet private kombëtare. Në këto kushte kërkesa mbeti pa

objekt.

Meqenëse sipas kërkuarit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit nuk jep më asnjë licencë, kërkohet zëvendësimi i subjektit të interesuar të Kuvendit të Shqipërisë me subjektin “Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit” dhe ndryshimi i objektit të kërkesës për detyrimin e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit që të pajisë me licencë për transmetim televiz ose radioje subjektet e interesuara, të cilat i plotësojnë kriteret ligjore.

Kërkesa që u paraqit në seancë për vazhdim të gjykimit, duke ndryshuar subjektet dhe objektin e kërkesës, nuk ka bazë ligjore, prandaj Gjykata Kushtetuese, me vendim të ndërmjetëm, e rrëzoi atë. Kur kërkesës i ndryshon njëkohësisht si objekti, edhe subjektet e interesuara, ajo merr cilësinë e një kërkesë të re, ndërsa kërkesa e parë mbetet pa objekt. Në kushtet të tilla, Gjykata Kushtetuese është e detyruar që të vendosë pushimin e çështjes për mungesë të objektit të kërkesës. Lidhur me këtë vetë, kërkuari parashtroi në kërkesë se Kuvendi e ka kryer detyrën e tij, sepse e ka ndryshuar ligjin duke e përputhur atë me Kushtetutën dhe me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131 e 134 të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Pushimin e gjykimit të çështjes.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.